



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 4367 / Prot  
2

Fier më, 18 04 /2025

**PROCES VERBAL**

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 18.04.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 13:00. Të pranishëm në mbledhje 29 këshilltarë.

Znj.Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë ! Mbledhja e këshillit bashkiak të qytetit filloj pak me vonesë për shkak se kemi filluar ta transmetojmë live, dhe specialistët kanë ende disa probleme të cilat e bënë të pamundur fillimin në orar të kësaj mbledhje. Përpara se të fillojmë me rendin e ditës i drejtohem sekretarisë nëse është krijuar kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Z.Armando Çupa

Po, kuorumi është arritur dhe mund të vazhdojë zhvillimin e mbledhjes. Faleminderit!

Z.Ilia Fili

Sa është pjesëmarrja, ju lutem?

Znj.Antoneta Çunaj

Janë 29(njëzet e nënëtë) këshilltarë të pranishëm.Tani m.q.s është krijuar kuorumi e deklarojë mbledhjen të hapur. Fillojmë me rendin e ditës i cili ju është komunikuar elektronikisht. Nga rendi i ditë është hequr pika e 5-të nga ana e administratës.

**Pika e parë e rendit të ditës.**

Miratimi i rendit të ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakort?

Z.Kreshnik Dapi

Do të votohet për rendin e ditës pa pikat shtesë vetëm me heqjen e pikës 5?

Znj.Antoneta Çunaj

Po dhe më pas do të votojmë pikat shtesë. Kush është dakort?

Pro 29 vota.

Abstenim nuk ka.

Kundra nuk ka .

Miratohet .

Znj.Antoneta Çunaj

Kanë ardhur edhe 4(katër) pika shtesë të cilat janë:

**Pika e parë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “ Për një shtesë për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , në kuadër të VKM-së nr.660, datë. 23/10/2024“ Për shpronësimin për interes publik,të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qëndrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.

**Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për miratimin e Planit rrugor për Pasaportën me nr.258, Kodi nr.1/54.”

**Pika e tretë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për dhënen e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin MARS 2025”

**Pika e katërt shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.”

Znj.Antoneta Çunaj

Për sa i përket pikës së tretë shtesë të rendit të ditës, sqaroj se , është futur si pikë shtesë pasi në momentin që është zhvilluar mbledhja e kryesisë nuk kishte dalë akoma konfirmimi nga sistemi.Kush është dakort pëti futur në rendin e ditës këto pika shtesë?

Z.Ilia Fili

Znj. Kryetare unë sygjeroj që pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me investimet dhe me shpenzimet që do të kryhen nga bashkia të shtyhen për mbledhjen pas 11 Majit, mos të ekzekutohen, të mos miratohen dhe të mos i kalojmë tani.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk ka asnjë shpenzim që do të kryej bashkia në pikat shtesë të rendit të ditës,

Z.Ilia Fili

Tek pika e parë ku flitet për shpronësimet e pronave private, kjo është para që del, lëreni mbas 11 Majit.

Znj.Antoneta Çunaj

Ky shpronësim nuk do të kryhet tani, është thjeshtë procedurë. Nuk do të fillojnë të shpronësohen sot ato, i nderuar këshilltarë.

Z.Ilia Fili

Unë këtë këshill jap.

Znj.Antoneta Çunaj

Ky projekt ka dalë shumë kohë përpara, që në kohën e miratimit nga ana e qeverisë të projektit të “100 Fshatrave”. Ky projekt ka filluar dhe është implementuar në Libofshë dhe për këtë arsyen nuk kemi të bëjmë me fonde që do të jepen nga bashkia në këtë moment. Shpronësimi do të kryhet në një kohë të mëvonshëm. Kush është dakort me katër pikat shtesë të rendit të ditës?

Pro 24 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim 5 vota.

Nuk miratohen.

Z.Elvi Daka

Kryetare, unë sygjeroj që ti miratojmë pikat shtesë një e nga një.

Znj.Evis Sema

Kryetare, nuk do ti marrësh të gjitha pikat shtesë për ti miratuar në bllok sepse për interesat e qytetarëve nuk mund të lihen pa u miratuar 6% apo pranimi në shtëpinë e të moshuarve.

Znj.Antoneta Çunaj

Për cilat pika është abstenimi juaj, të nderuar këshilltarë, për të gjitha pikat, apo vetëm për ndonjë prej tyre?

Znj.Yllka Sheshi

Vetëm për shpronësimet në Libofshë.

Z.Kreshnik Dapi

Vetëm për shpronësimet në Libofshë. Nuk e kuptoj pse duhet të nxito hemi?

Znj.Antoneta Çunaj

Përveç shpronësimeve në Libofshë, ka ndonjë kundërshtim tjetër nga ana juaj për pikat e tjera shtesë?

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Nga ana e ekzekutivit, materiali ju është dhënë pesë ditë para mbledhjes sipas afatit ligjor, nëpërmjet sekretarit të këshillit të bashkisë Fier. Kjo nuk është një pasuri që ne rastësisht e gjetëm dhe e futëm në këtë procedurë shpronësimi. Kjo është një pasuri që ka qënë në atë procedurë shpronësimi, që është miratuar nga ky këshill, por që nuk është vlerësuar me vlerë financiare për të vazhduar më tej në ministri për shkak se nuk kishte dokumentacion pronësie. Pra m.q.s praktika administrative në institucionet shtetërore është ndërprerë deri sa familja e Drita Sukullit ka marrë certifikatën e pronësisë përfshirë shpronësimi, dhe në këto kushte ne e fusim për një shtesë, pra nuk doli rastësisht kjo pasuri dhe jo pa qëllim kemi cituar 16/24,N3,N4,N5 dhe N6 është e Znj.Drita Sukulli prandaj dhe futet në këtë moment në këshill . Ajo është një procedurë që do të vijojë.

Znj.Yllka Sheshi

Në momentin që janë zgjedhjet përpara, kjo është arsyaja pse ne po abstenojmë. Mua kjo gjë nuk më bind.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Po e përsëris edhe njëherë. Kjo nuk është një pasuri që doli rastësisht, në relacion e keni të detajuar. VKM-ja për shpronësimin e qëndrës së Libofshës, të ka dalë me katër pasuri të lidhura me njëra tjetrën, kjo pasuri nuk është pajisur me certifikatë pronësie në atë periudhë, u pajis tani dhe procedura e shpronësimit ju është dhënë juve për miratim.24N3, 24N4, 24N5 janë miratuar dhe 24N6 ëstë kjo që miratohet për një shtesë në VKM. Nuk është një pasuri që doli rastësisht, është një pasuri që ka qënë në gjurmën e projektit të rikualifikimit të qëndrës së Libofshës. Nqs nuk doni ta miratoni është e drejta juaj. Nga ana e ekzekutivit është sjellë këtu ky projekt vendim për të ezauruar rrugën administrative, është e drejta juaj ta votoni apo jo.

Z.Kreshnik Dapi

Ne nuk jemi kundra akteve dhe projekt vendimeve që vijnë në interes të komunitetit dhe qytetarëve. Problemi është që ju po na kërkoni që ne ta miratojmë, por ne materiali na ka ardhur shumë vonë. Edhe tani që ju po na e shpjegoni në detaje ne nuk kemi material përpëra, në tavolinë nuk kemi asgjë. Ky material ka ardhur vetëm në grupin e WhatsApp dhe ju kemi thënë me qindra herë...

Z.Arndando Çupa

Më falni Z.Dapi. Materialet janë hedhur të gjitha brenda afatit ligjor. Për sa i përket pjesës që ju po përmendni për t'i patur fizikisht, kryetarja në të gjitha mbledhjet e ka bërë të qartë që kush do që ka dëshirë ti marri materialet fizike , të paraqitet pranë sekretariatit. E kemi thënë kaq herë.

Znj.Antoneta Çunaj

Ky material ka ardhur dhe u është vënë në dispozicon të gjithë këshilltarëve brenda afatit ligjor. E kemi thënë shumë herë që nuk mund të bëjmë materiale fizike për aq kohë sa nuk keni ju interes për ti térhequr ato. N.q.s i doni fizikisht, shkon tek sekretari dhe i merrni. Kemi komunikuar gjithmonë në mënyrë elektronike brenda afateve ligjore. Mgjth asnjë nga këshilltarët nuk është ndaluar për ti marrë fizikisht materialet në sekretariat.

Z.Ilia Fili

Zonja kryetare, që po na e përmendni këtë gjë, bëni mirë. Kjo që thatë tani është e drejtë që kush do nga ne mund të shkojë në sekretari. Por pse nuk përmendni këtu vendimin që është marrë para tre muajsh për të na pajisur me tabletë për të lexuar materialet?

Znj.Antoneta Çunaj

Është në proces prokurimi.

Z.Ilia Fili

Prisni të më mbarojë mandati mua, dhe pastaj na pajisni.

Znj.Evis Sema

Unë propozoj që katër pikat shtesë të miratohen një e nga një. Të futen në rendin e ditës dhe pastaj kur administrata të japi shpjegimet përkatëse, secilit prej këshilltarëve duke dëgjuar sqarimet, mund të binden për ti miratuar. Sepse duke i kaluar në bllok ka paqartësi nga ana e këshilltarëve.

Z.Elvi Daka

Më falni, kryetare të bëj një sqarim. Kjo historia e të moshuarës Drita Sukulli, ka mbi tre vite që ajo përpinqet që të marri dokumentin e pronësisë dhe e falenderojmë administratën që kjo shtetase më në fund është pajisur me dokumentin e pronësisë, dhe ne e presim që ta miratojmë këtu. Në fakt ajo godinë aty është, një godinë që dhe në hartat shpjeguese ka qënë godinë ekzistuese. Pingohej shpronësimi vetëm për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë të të moshuarës Drita Sukulli. Kështu që nuk mund të penalizojmë në këtë rast hapjen e një procedure shpronësimi pasi aty investimi është bërë, godina ka qënë ekzistuese, është e njohur dhe nuk e kuptoj arsyen pse duhet ta pengojmë ne këtë gjë?

Znj.Antoneta Çunaj

Ka ndonjë mendim ndryshe nga ana e këshilltarëve që abstenuan?

Znj.Evis sema

I ftoj të gjithë këshilltarët që abstenuan të votojnë pro futjes së këtyre pikave në rendin e ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Miratojmë tre pikat e tjera shtesë të rendit të ditës përvèç pikës së parë shtesë. Kush është dakort?

Pro 29 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Znj.Antoneta Çunaj

Në lidhje me pikën e parë shtesë, ju që abstenuat në fillim i qëndroni këtij mendimi? E hedhim edhe njëherë në votim këtë pikë shtesë.Kush është dakort?

Pro 26 vota

Kundra nuk ka

Abstenim 3 vota.

Miratohet.

Z.Arben Çuko

Të sqarojmë një diçka këtu. Ne nuk jemi kundra shpronësimit apo investimeve në rrugë por kemi hasur në faktin që hidhet zhavor elektoral prandaj jemi kundër ne. Unë e kam hasur këtë fakt në Pirrë dhe në Radostinë kështu që ta kenë të qartë dhe qytetarët pse abstenojmë ne.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk është për të hedhur zhavor elektoral kjo pikë, por është thjeshtë për të vazhduar procedurën vetëm një person i cili nuk i ka patur dokumentat e rregullta, nuk e ka patur pronën të certifikuar në ASHK dhe tanë pas shumë kohësh ka mundur të nxjerri certifikatën dhe prandaj kërkohet vijimi i procedurës.

Z.Arben Çuko

Dhe ne prandaj e votuam.

Znj.Yllka Sheshi

Dhe për ironi të fatit ky shpronësim ne na vjen në këtë moment që jemi dhe në fushatë zgjedhore, dhe për dy javë kemi zgjedhjet. Kjo është arsyja që ne jemi skeptikë dhe që na bëri ne si subjekt i PL-së që në votimin e parë të abstenomin, pasi mund të priste dhe dy-tre javë deri sa të mbylleshin zgjedhjet.

Znj.Antoneta Çunaj

Ne shyqyr që për interes publik gjemjë qytetarë të përgjegjshëm që jadin pronën e tyre për zhvillimin e qytetit. Pra miratuam rendin e ditës bashkë me katër pikat shtesë.

#### **Pika e dytë e rendit të ditës.**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.03.2025

Znj.Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.03.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dokort ?

Pro 28 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim 1 votë

Miratohet.

#### **Pika e tretë e rendit të ditës**

Projekt vendim “Për miratimin e Planit të masave përmbrojtjen kundra zjarrit dhe Planit të Veprimit”

Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht do të flasi përfaqësuesi i bashkisë.

Z.Ildo Trofoni

Përvendetje! Unë jam inxhinieri i pyjeve në drejtorinë e Mbrojtjes së Pyjeve, Mjedisit dhe Pronës Publike. Miratimi i Planit të masave përmbrojtjen kundra zjarrit dhe Planit të Veprimit, është bërë praktikë e përvitshme nga drejtoria jonë në zbatim të ligjit të Pyjeve Nr.57 të vitit 2020, neni 30, dhe ky plan masash ka për detyrë, zbatimin që do të bëjmë ne lidhje me situatat e mundëshme të krijuara në bashkëpunim me drejtorinë e Zjarrëfikseve dhe Emergjencave Civile. Do të ngrihen shtabe në këto drejtori dhe në çdo Nj.A dhe vullnetarët të cilët do të krijojnë grupet për shuarjen e zjarreve.

Znj.Antoneta Çunaj

Ky material ju ka ardhur. Ka dëshirë ndonjë këshilltarë për të diskutuar apo sqaruar? Nëse jo e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 29 vota

Kundra nuk ka

Abstenim nuk ka.

Miratohet

**Pika e katërt e rendit të ditës.**

Projekt vendim: “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore ne Zk.3358, fshati Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”

Znj.Antoneta Çunaj

Fjalën e ka përfaqqësuesi i bashkisë.

Z.Arblion Behari

Ky material është preqatitur mbi bazën e një kërkese të paraqitur nga ASHK-ja e cila kërkon miratimin e listës së përdoruesve faktikë në fshatin Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë. Bazuar në Ligjin 20/2020 neni 12, brenda gjashtë muajve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit, të gjitha subjektet që posedonin në mënyrë të ligjshme një tokë bujqësore, por nuk kishin një titull fitimi pronësie, mund të paraqitnin brenda gjashtë muajve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit, kërkuesat pranë Nj.A përkatëse për të kërkuar kalimin në pronësi pa shpërbirim të tokës bujqësore. Janë paraqitur kërkuesat nga subjektet përkatës, janë depozituar në ASHK nga Nj.A brenda afatit të përcaktuar nga ligji. Është ngritur një grup pune i cili në bashkëpunim me Nj.A ka verifikuar parcelat sipas kërkësave të paraqitura në Nj.A Topojë. Janë hartuar plan vendosjet mbi bazën e konstatimeve në terren, janë hartuar relacionet përkatëse, është hartuar lista e përdoruesve faktikë nga ana e ASHK-së e cila është afishuar edhe në bashki edhe në Nj.A përkatëse. Nuk ka patur ankesa. Mbi bazën e nenit 14 të Ligjit 20/2020, i cili e ka të përcaktuar se lista e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore i përcillet për miratim këshillit bashkiak, ASHK-ja ka kërkuar miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore në fshatin Sheq Marinas Nj.A Topojë. Mbi bazën e kësaj kërkese kemi preqatitur edhe materialin për këtë projekt vendim. Është mbledhur komisioni përkatës. Kemi edhe përfaqqësues të ASHK-së këtu n.q.s keni donjë pyetje shtesë apo doni ndonjë sqarim në lidhje me këtë projekt vendim.

Z.Melsi Bogdani

Kam një pyetje. Mos ka ndonjë mbivendosje të pronave?

Z.Arblion Behari

Jo, janë kryer të gjitha verifikimet përkatëse.

Z.Kreshnik Dapi

Për ata që nuk e dinë, çfarë nënkupton termi përdorues faktik i tokës? Pyetja e dytë. Si e kanë siguruar këtë tokë këta qytetarët që janë në atë listën e ASHK-së?

Znj.Antoneta Çunaj

E kanë siguruar me anë të Ligjit 7501 për ndarjen e tokës bujqësore, me titull pronësie.

Z.Kreshnik Dapi

Pyetja e tretë. Ka ndonjë plan zhvillimi në atë rajon, pasi pash që ishte një numër i madh pronarësh aty apo përdoruesish faktikë?

Z.Marjus Voja

Kreshnik, janë toka bujqësore dhe nuk ka asnë plan zhvillim.

Znj.Antoneta Çunaj

Për tokat bujqësore ka një Ligj dhe VKM, që edhe 500 m të kërkohet të shfrytëzohet duhet të marri miratimin nga ministria përkatëse për tu përdorur për qëllime të tjera jo bujqësore. Është në mënyrë kategorike e ndaluar që toka bujqësore të përdoret për qëllime të tjera.

Z.Kreshnik Dapi

Ne këtu kemi qënë dhe kemi votuar vetë ndryshimin e Bonitetit, të destinacionit, po flas se ajo është një zonë shumë sensitive. Ne nuk jemi kundra interesit qytetarë, as të dalim jashtë kuadrit ligjor apo të bëjmë gjëra të tjera, ne kemi për detyrë si këshilltarë që përparrë se të ngrejmë dorën që të votojmë për një gjë që na kërkohet nga administrata, të kérkojmë sqarim dhe informacion pasi nuk jemi ekspert të çdo fushe, aq më tepër kur informacioni për këshillin është shumë i vakët. Nuk ka asgjë të keqe në faktin që ne kérkojmë informacion, nuk e kérkojmë vetëm për vetë por edhe për ata që na shikojnë live.

Z.Arbiion Behari

Informacioni dhe materialin jua kemi dërguar, edhe mbledhjen e komisionit e kemi bërë.

Z.Kreshnik Dapi

Për atë unë kam vërejtje. Për pyetjet që bëra , mora përgjigje, ju faleminderit. Ne si grup nuk jemi kundra.

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni përkatës për këtë projekt vendim?

Znj.Erlinda Llupi

Po, komisioni është mbledhur dhe të gjithë anëtarët e komisionit që ishin prezent ishin pro kalimit të këtij projekt vendimi për shqyrtim në këshillin bashkiak.

Z.Ilia Fili

Unë kam një sqarim. Personat që janë në listë janë zotërues të tokës. Miratimi i kësaj liste çfarë efekti ka?

Znj.Antoneta Çunaj

Janë sistemuar. Është zona kадestrale inxhinier? Është parcelizuar sipas personave dhe sipas sipërfaqeve që kanë në këtë zonë kадestrale të gjithë këta pronarë të tokës.

Z.Ilia Fili

Kujt i shërbën kjo listë?

Znj.Antoneta Çunaj

Kjo shkon në Kadastër për tu certifikuar. Ka një gjë që ndryshe nga më parë kur kryhej certifikimi i pronës në tërësi dhe më pas bëhej zbërthimi i ngastrës, tani nuk bëhet asnjë certifikim i pronave pa bërë në terren zbërthimi i të gjithë zonës Kadestrale, pa u vendosur të gjithë pronarët e tokës sipas ligjit 7501 dhe më pas kjo hartë së bashku me subjektet përkatëse i shkon ASHK-së që secili të certifikojë tokën bujqësore në bazën e pozicionit që ka në harë dhe sipërfaqes që ka në AMTP.

Z.Ilia Fili

Ky është pozitiviteti kur e ke kryetaren e këshillit jurist, avokate.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakort për pikën katër të rendit të ditës?

Pro 29 vota.

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

#### **Pika e parë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “ Për një shtesë për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , në kuadër të VKM-së nr.660, datë. 23/10/2024“ Për shpronësimin për interes publik,të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qëndrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën për diskutim?

Z.Ilia Fili

Miratimin e kësaj pike sikurse e thashë dhe më parë shtyheni për mbledhjen tjetër, mbas zgjedhjeve.

Znj.Evisa Sema

Ju lutem këshilltarëve të marrin të gjithë informacionin e duhur nga ana e administratës për këtë pikë përpara se të kalohet në votim.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Informacioni për këtë piku ju është dhënë brenda afateve ligjore si projekti vendimi ashtu edhe relacioni dhe fotot përkatëse. Nuk besoj se ka nevojë më për sqarime të tjera përvçe atyre që i dhamë më lartë. Gjithësesi të vendosin vetë këshilltarët.

Z.Melsi Bogdani

Inxhinier, ne mund të marrim vendim paraprakisht për të filluar si procedurë dhe mund të bëhet shpronësimi faktik pas zgjedhjeve, por të paktën të fillojë si procedurë pasi ajo është kryefamiljare dhe mezi e ka pritur këtë moment.

Znj.Evisa Sema

Por edhe nga ana ligjore nuk përbën asnjë konflikt interes i për tu mos u kaluar, kështu që të marrin të gjithë informacionin, të sqarohen. Ja ku është edhe administrata dhe të shikohet projekt vendimi sepse kjo nuk ka lidhje me zgjedhjet.

Z.Kreshnik Dapi

Unë jam i mendimit për ta kaluar.

Znj.Antoneta Çunaj

Ashtu siç e theksova, kjo është thjeshtë procedurë.

Z.Arnanado Çupa

Kjo është një fillim shpronësimi, procedurë e cila më pas do të plotësohet nga VKM-ja. Ne po i hapim rrugën fillimit të procesit, nuk po japim asnjë lekë përfushatë.

Znj.Antoneta Çunaj

Në këtë rast, kjo zonjë që do të jetë në proces shpronësimi merr zero lekë. Këto dokumenta i shkojnë qeverisë. KM bën një vlerësim paraprak sa shkon vlera e shpronësimit, dhe ajo ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve ta kontesojë nëse nuk është dakortë me vlerën që i jep shteti për shpronësim, dhe më pas bëhet miratimi nga KM i vlerës së shpronësimit të ndërtimit dhe të tokës që do të marri shteti për interes publik. Në rastin konkret nuk jemi tek vlera por jemi tek fillimi i procedurës për shpronësim publik të një individu, të një gruaje të moshuar, që ka arritur të bëjë sipas ligjit regjistrimin e pronës.Ta hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 28 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

### **Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për miratimin e Planit rrugor për Pasaportën me nr.258, Kodi nr.1/54.”

Znj.Antoneta Çunaj

Për këtë ju ka ardhur materiali si projekt vendimi dhe relaciuni përkatës. Bëhet fjalë për zonën ku është ETC-ja që është në zhvillim e sipër. Ka ndonjë nga këshilltarët që kërkon sqarim në lidhje me këtë projekt vendim?

Z.Armando Çupa

Më fal kryetare. Të bëj edhe një shtesë në lidhje me këtë projekt vendim. Ky projekt vendim ka kaluar edhe në dëgjesë publike, ku unë kam qënë prezent. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Sygjerimet tona për semaforë dhe korsi bicikletash janë marrë në konsideratë?

Z.Ilia Fili

A mund ta hiqni atë fjalën pasaportë dhe ti vendosni ndonjë fjalë tjetër se mos na ngatërroni me atë pasaportën Europiane, se na vdiqët me këto pasaportat tuaja.

Znj.Antoneta Çunaj

Jo more inxhinier, mos u shqetëso, se nuk ngatërrrohet kjo pasaportë e terminologjisë urbanistike me atë pasaportë që thoni ju. Ka ndonjë diskutim? M.q.s nuk ka asnjë diskutim, le ta hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 28 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

**Pika e tretë shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin MARS 2025”

ZnjAntoneta Çunaj

Ashtu siç jua thashë paraprakisht, qytetarët përfundin 6% përzgjidhen nga sistemi, dhe fondi financiar përkëtë 6% nuk është më shumë se 200(dyqind) mijë lekë të reja, përtë gjithë ato familje që përfitojnë nga ky fond. M.gj.th le t'i japim fjalën përsqarime më të hollësishme nënkyrjetares së bashkisë që mbulon drejtorinë përkatëse që ka propozuar këtë projekt vendim.

Znj.Suela Prifti

Përvendetje! Jemi këtu përtë paraqitur projekt vendimin përmiratimin e fondit të kushtëzuar 6 % përmuajin Mars. Nga ky fond përfitojnë 46 (dyzet e gjashtë) familje dhe vlera e fondit është 206 mijë e 476 lekë. Nga skema dalin gjashtë familje të cilët , duke qënë se kanë muaj që e kanë përfituar këtë fond ekonomik, përfektivisht, dalin nga skema përtë parë ndryshimin e statusit të tyre financiar dhe kanë hyrë në këtë skemë katër familje të reja. Njëra nga familjet është nga Nj.A Qëndër dhe tre familjet e tjera janë nga Rajoni nr. 3 i Bashkisë Fier. Njëri është kryefamijlar i gjinisë mashkulllore dhe tre të tjerat janë të gjinisë femërore. Sipas verifikimeve që janë bërë nga ana e administratorëve social, është parë që kushtet financiare të tyre dhe gjëndja ekonomike nuk janë të mira, dhe përkëtë arsyen janë bërë pjesë e kësaj skeme dhe e këtij fondi.

ZnjAntoneta Çunaj

Në krahasim me muajin shkurt si është numri i këtyre familjeve?

Znj.Suela Prifti

Në muajin e mëparshëm kemi patur 48(dyzet e tetë) familje ndërsa këtë muaj kemi 46(dyzet e gjashtë) familje, pra kemi dy familje më pak.

Z.Ilia Fili

Unë mendoj që edhe sqarimi që bëri nënkyetarja ishte i tepërt sepse ne e kemi çdo muaj këtë problem, por mua nuk më pëlqen kjo gjë që thoni ju kryetare e këshillit, që përzgjedhjen për këto familje e bënë sistemi. Sistemin e bëjnë njerëzit. Mos na bindin me fjalën sistem. Por unë në parim jam dhe do të jem si gjithë kolegët e tjerë që kjo kategori ka nevojë për ndihmë dhe duhet ndihmuar, dhe nuk kemi nevojë për shpjegime të përmuajshme për arsyet e dhënies së këtij fondi.

Znj.Yllka Sheshi

M.q.s jemi në këtë pikë, për njerëzit që nuk kanë mundësi ekonomike, mund të them që ka gati dy- tre muaj, që një zonjë, përbri shkollës “Janaq Kilica” që është e stacionuar atje, fle atje, ha, pi, gjithçka atje. A mundet që t'i jepet një zgjidhje pasi bën një figurë shumë negative qëndrimi i saj atje ditë- natë, nuk e di mbasë ka dhe probleme shëndetësore, se bëri gati dy javë që nuk ishte atje. Pas kësaj periudhe erdhi e kuruar, e larë , e rregullt por përsëri filloi të përsëritet e njëjta situatë me të . Mendoj që ti gjejmë një zgjidhje kësaj zonje, në një azil...

Z.Vasil Bregu

Nga informacioni që disponoj unë, kjo zonjë është banore e bashkisë së Patosit sepse kemi kontaktuar nëpërmjet institucioneve tona. Edhe ne e kemi hasur problemin e kësaj zonje, kemi kontaktuar edhe me policinë dhe problemi është që kjo zonjë është banore e bashkisë Patos dhe konkretisht e qytetit të Patosit. Si pasojë e problemeve mendore që ka largohet nga shtëpia dhe qëndron atje jashtë.

Znj.Yllka Sheshi

Të shikohet mundësia që duke bashkëpunuar të dy bashkitë bashkë ti jepet një zgjidhje rastit të kësaj zonje.

Znj.Antoneta Çunaj

Administrata e bashkisë të marri masa duke bashkëpunuar edhe me bashkinë e Patosit, që shqetësimi i ngritur nga ana e këshilltares të marri zgjidhje sa më shpejtë. Duke u kthyer tek pika e tretë shtesë e rendit të ditës, nëse nuk ka më pyetje dhe diskutime atëherë le ta hedhim në votim këtë pikë. Kush është pro?

Pro 29 vota.

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

#### **Pika e katërt shtesë e rendit të ditës.**

Projekt vendim “Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.”

Znj.Antoneta Çunaj

A dëshiron dikush të flasë? Mqs nuk ka asnjë këshilltarë që do të flasi në lidhje me këtë projekt vendim, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 29 vota.

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Znj Antoneta Çunaj

Faleminderit të gjithë këshilltarëve të pranishëm për bashkëpunimin!

Ky proces verbal ka 13 (trembëdhjetë) faqe, mbahet në tre kopje nga Sekretari i Këshillit Z. Arnando Çupa

Sekretari i Këshillit

Arnando ÇUPA

Kryetar i Këshillit

Antoneta ÇUNAJ

